



DEKOSIL

Ngjyrat	Paketimi	Koha e tharjes në prekje
Transparent, E bardhë, Gri, Bezhë	280 ML	8-15 min

PËRSHKRIM

Silikon njëkomponent, me bazë aceti, që ngurtësohet në temperaturë ambiente kur ekspozohet ndaj lagështisë atmosferike, duke formuar një gomë silikonit fleksibël dhe të qëndrueshme. I dizajnuar posaçërisht për ngjitje dhe silikonim, ofron hidroizolim të shkëlqyer dhe ngjitje afatgjatë në një gamë të gjerë sipërfaqesh jo poroze.

Ngjyrat në dispozicion: Transparent, E bardhë, Gri dhe Bezhë.

KARAKTERISTIKAT

- Shume i lehte në aplikim dhe lëmim
- Rezistencë ndaj mykut, rrezeve UV, lagështisë dhe kushteve atmosferike
- Tharje e shpejtë
- Elastik në mënyrë të përhershme
- Nuk rrëshqet, qëndron në nyje dhe kënde

FUSHA E APLIKIMIT


- Izolim dhe silikonim yjesh në ambiente të brendshme dhe te jashtme
- Izolim dhe silikonim në lavamanë, vaska, dush, pishina
- Izolim për tubacione të ujit, shkarkime dhe tuba PVC
- Qelq
- Izolim dhe silikonim për pllaka qeramike
- Sipërfaqe të veshura me xham
- Sipërfaqe me Fibra qelqi
- Silikonim i sipërfaqeve me prej alumini te anodizua

PËRGATITJA E BAZAMENTIT

Sipërfaqet duhet të jenë të thata, të pastra nga pluhuri, grimcat dhe vaji. Në vendet ku ka papastërti, duhet të pastrohen me tretës dhe leckë pambuku të pastër. Tretësi i tepërt duhet të largohet para se të avullojë. Temperatura e aplikimit: +5 °C deri +40 °C.

APLIKIMI

Tub standard: Prit majën e filetuar të tubit dhe vendos tubin e aplikimit. Vendos tubin në pistoletën e silikonit dhe shtyp dorezën për të mbushur grykën me silikon. Pas aplikimit bëhet lëmimi i sipërfaqes me mjet të përshtatshëm (p.sh. spatul). Hiq mbetjet e tepërta. Sipërfaqja ku aplikohet silikonit duhet të mbrohet nga papastërtit e ndryshme si dhe ngarkesa mekanike deri në ngurtësim. Në nyje të gjëra ose të lëvizshme, përdor materiale ndihmëse si tub mbështetës për të ruajtur formën dhe trashësinë e duhur. Siguro ventilm të mirë gjatë dhe pas aplikimit.



TË DHËNAT TEKNIKE

Dendësia: 0.96 g/ml	Intensiteti i rritjes mikrobiale (ISO 846): 1
Paketimi: 280 ml	Temperatura e shërbimit: -40 deri +100 °C
Ngjyra: Transparente, E bardhë, Gri, Bezhë	Temperatura e aplikimit: + 5°C deri në + 40°C
Koha e tharjes në prekje: 8-15 min	Fortësia Shore A (ISO 868): 13 – 14
Koha e formimit të shtresës : 20-30 min	Modul elastik 100% (ISO 37): 0.21 – 0.23 N/mm ²
Shkalla e ngurtësimit: 1.8 – 2.0 mm/24h	Forca tërheqëse (ISO 37): 1.1 – 1.4 N/mm ²
Humbje vëllimi (ISO 10563): <30 %	Magazinimi: 12 muaj nga data e prodhimit.
Rezistencë ndaj rrjedhjes (ISO 7390): 0 mm	



KUJDES ! Nuk përdoret mbi sipërfaqe bituminoze ose materiale që mund të lëshojnë vajra/plastifikues (p.sh. goma natyrale, etj.

- Korroziv për metalet e pambuluara
- Ngjitje e dobët me sipërfaqe shumë poroze
- Nuk ngjitet në polietileni , polipropileni ,teflon
- Nuk rekomandohet për gurë natyrorë

Gjithmonë bëni një test paraprak për përputhshmëri dhe ngjitje. Nëse është e nevojshme, përdorni primer për përmirësim ngjitjeje. Respektoni datën e skadencës.